

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri dhe me sekretaren juridike Drita Ujupi, në lëndën penale kundër të akuzuarit N.I. nga Shtimja, i akuzuar sipas aktakuzes së Prokuroris Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2663-1/14, e dt. 03.04.2015 për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga nen.398 par.1 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 30.12.2016, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, si dhe të akuzuarit, shpalli dhe komunikoi ndërsa me datë 16.01.2017 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **N.I.** nga Shtimja, rr.”.....”, data e lindjes..... në, nga i ati J. dhe e ëma H., e gjinisë M., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor teknik i gjeodezisë, i gjendjes së mesme ekomomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse gjatë muajit qershor 2014, në kohë të pacaktuar, në shtëpinë e tij, në Shtime rr.”.....”, në mënyrë të kundërligjshme ka përpiluar një dokument – fletëpagesë, duke i falsifikuar dy shkresa zyrtare të lëshuara nga Gjykata kinse e ka kryer pagesën e dënimit me dy këste dhe atë këstin e pare me date 21.03.2014 në shumën prej 70€ dhe këstin e dytë me date 27.08.2014 në shumën prej 100€, gjithsej në shumë prej 170€, duke skanuar pjesë të shkresave zyrtare që kishte pranuar Gjykata, vulën e pranimi të aktvendimit P.nr.777/12, nga dokumenti tjetër .”Urdhëri për mbajtjen e dënimit”, ka skanuar logon e Gjykatës, vulën së bashku me nënshkrimin e bashkëpunëtorit profesional dhe i ka vendos në dokumentin e falsifikuar dhe të njëjtin document të falsifikuar e prezanton kinse e ka paguar dënimin me gjobë prej 150€ si dhe paushallin gjyqësor prej 20€ gjithsej 170€ sipas aktgjykimit P.nr.777/12 të Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Me të cilën ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga nen.398 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 4,6,7,23,41,43,46 dhe 73 të KPK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e

G J Y K O N

DENIM ME GJOBË në lartësi prej 400 (katërqind) euro, të cilin denim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara në nen. 46 të KPK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzet) € i pandehuri do të vuaj një ditë burgu.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 69 par.1 të KPRK-së fletëpagesa EDGJ.nr.142/14 e dates 27.08.2014 konfiskohet.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2663-1/14, e dt. 03.04.2015 e ka ngarkuar të pandehurin N.I. për veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga nen.398 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 30.12.2016 në të cilin Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani, në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin të shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I pandehuri N.I., në shqyrtimin fillestar, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave, duke theksuar se për këtë vepër është pënduar thellë, se duke premtuar se ë të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, duke e lutur gjykatën që ti shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës siç janë: deklarata e të pandehurit e dhënë me autorizim të prokurorit e dt.27.10.2014, vërtetimi mbi marrjen e përkoshme të sendeve i datës 27.10.2014, urdhëri për mbajtjen e dënimit i lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj i datës 21.03.2014, njoftimi i datës 27.08.2017, deklarata e dëshmitarit A.B. e dhënë me autorizim të prokurorit të shtetit me datë 27.10.2014 si dhe dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabim faktik.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, kryetari i trupit gjykues konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga nen. 320 të KPK-së, si në datën, kohën dhe vendin siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi i pandehuri në mënyrë të kundërligjshme ka përpiluar një dokument – fletëpagesë, duke i falsifikuar dy shkresa zyrtare të lëshuara nga Gjkata kinse e ka kryer pagesën e dënimit me dy këste dhe atë këstin e pare me date 21.03.2014 në shumën prej 70€ dhe këstin e dytë me date 27.08.2014 në shumën prej 100€, gjithsej në shumë prej 170€, duke skanuar pjesë të shkresave zyrtare që kishte pranuar Gjkata, vulën e pranimit të aktvendimit P.nr.777/12, nga dokumenti tjetër ”Urdhëri për mbajtjen e dënimit”, ka skanuar logon e Gjykatës, vulën së bashku me nënshkrimin e bashkëpunëtorit profesional dhe I ka vendos në dokumentin e falsifikuar dhe të njejtin document të falsifikuar e prezanton kinse e ka paguar dënimin me gjobë prej 150€ si dhe paushallin gjyqësor prej 20€ gjithsej 170€ sipas aktgjykimit P.nr.777/12 të Gjykatës Themelore në Ferizaj

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, se është punëtor, se i njejtë është penduar shumë, se tani është martuar, premtimin se në të ardhmen më nuk do të përsërisë veprime të tilla apo të ngjajshme, e në mungesë të rrethanave rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të te pandehurit dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, te pandehurit i vërtetoi dënim me gjobë në shumën prej 400€ me bindjen se në rastin konkret edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjesë së vepres penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Konform nenit 69 par.1 të KPRK-së fletëpagesa EDGJ.nr.142/14 e dates 27.08.2014 konfiskohet.

Konform nenit 450 par.2 nën par.2.6 dhe par.3 dhe neni 451 të KPPRK-së, i pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, e cila shumë është caktuar duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës dhe gjendjen ekonomike të pandehurit, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal, P.nr.402/15, dt.16.01.2017

Sekretarja Juridike ,
Drita Ujupi

Gjyqtari,
Mustaf Tahiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të kësaj gjykate.